

VENDIM
Nr.660, datë 25.9.2003

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PASURIVE TË PALUAJTSHME QË
PREKEN NGA SISTEMIM-ASFALTIMI I RRUGËS NGA QENDRA E QYTETIT NË
DREJTIM TË VARREZAVE, SISTEMIM-ASFALTIMI I RRUGËS NDËRMJET DY
SHKOLLAVE DHE NGA VENDOSJA E LAPIDARIT TË LUFTËS NË BASHKINË E
BILISHTIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5 pika 1, 20 e 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimin dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private, për interes publik”, me propozimin e Ministrit të Rregullimit të Territorit dhe të Turizmit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pasurive të paluajtshme të pronarëve, të cilët preken nga sistemim-asfaltimi i rrugës nga qendra e qytetit në drejtim të varrezave, sistemim-asfaltimi i rrugës ndërmjet dy shkollave dhe nga vendosja e lapidarit të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare në Bashkinë e Bilishtit.

2. Shpronësimi të bëhet në favor të Bashkisë së Bilishtit.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës që paraqitet në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për sipërfaqet prej 1129,5 m², vlerësuar në shumën e përgjithshme prej 1 129 500 (një milion e njëqind e njëzet e nëntë mijë e pesëqind) lekësh.

4. Fondi prej 1 129 500 (një milion e njëqind e njëzet e nëntë mijë e pesëqind) lekësh, për kompensimin e pronarëve të shpronësuar, të përballohet nga të ardhurat e Bashkisë së Bilishtit, për vitin 2003.

5. Vlera e shpenzimeve procedurale, në shumën prej 223 000 (dyqind e njëzet e tre mijë) lekësh, të përballohet nga Bashkia e Bilishtit, e cila do të kryejë edhe pagesën e pronarëve të shpronësuar.

6. Shpronësimi të fillojë dhe të përfundojë brenda periudhës 1-15 tetor 2003.

7. Punimet të përfundojnë brenda muajit nëntor të vitit 2003.

8. Ngarkohen Ministria e Rregullimit të Territorit dhe e Turizmit dhe Bashkia e Bilishtit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

Lista e pronarëve që do të shpronësohen si rezultat i sistemim-asfaltim rruge, qendër qyteti në drejtim të varrezave, sistemim-asfaltim rruge midis dy shkollave, vendosje e lapidarit të luftës ANÇ në Bashkinë Bilisht.

Nr.	Emri Mbiemri	Sip.tokë (m ²)	Njësia (lek m ²)	Vlera (lekë)
1.	Trashëgimtarët e Refat Nallbatit Shadie Refat Nallbati Alije Osman Spaho Ylver Raif Noke Pranvera Raif Noke Fatmir Hysen Nallbati Zhuljeta Nallbati	608 m ²	1000	608 000

	Mirela Skënder Nallbati Budjon Skënder Nallbati Firdes Hysen Nallbati Ritvan Hysen Nallbati Yllkë Fetri Nallbati Rudi Feti Nallbati Pëllumb Feti Nallbati Viktori Nallbati Dritan Fejzi Nallbati Valent Fejzi Nallbati Monika Fejzi Nallbati Romeo Fejzi Nallbati Fredri Fejzi Nallbati Fiqiri Zenel Nallbati Nexhat Zenel Nallbati Refiko Zenel Nallbati			
2.	Trashëgimtarët e Rushan Ajçes Esma Ajçe Ismail Rushan Ajçe Niko Rushan Ajçe Përparim Rushan Ajçe	139.5	1000	139 500
3.	Ymer Ramadan Shurdho	37	1000	37 000
4.	Nexhip Xhevair Bregu	315	1000	315 000
5.	Trashëgimtarët e Neki Skotit Merjeme Skoti Luan Neki Skoti Ferdane Neki Skoti Silvana Neki Skoti	30	1000	30 000

Shuma :

1 129 500